

Nr 3425 Prot

Belsh më: 13/01/2023

Lënda: Kthim Përgjigje.

QENDRA "RES PUBLICA"

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në përgjigje të shkresës Nr. 207/22 Prot. më datë 02.12.2022, protokolluar me tonën me nr.3425 datë 05.12.2022 me lëndë "Kërkesë për informacion për krijimin dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit" bazuar në nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", kërkesën për dhënie informacioni, regjistruar me numër rendor 17, datë 06/ 12/ 2022 në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, ju informojmë se:

1. A ju është marrë mendim për rishikimin e kufijve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM Nr. 59, datë 26.01.2022 "Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të zonave të mbrojtura mjedisore?

Në institucionin e Bashkisë Belsh nuk është marrë një mendim, në lidhje me rishikimin e kufijve të zonës së mbrojtur para miratimit të VKM Nr.59, datë 26.01.2022.

2. Nëse po, kopje të mendimeve /opinioneve të dhëna nga institucioni juaj në lidhje me këtë VKM.

Përderisa nuk është marrë asnjë mendim, rrjedhimisht nuk kemi kopje të tyre.

Ju faleminderit!

KRYETARI
Arif TAFANI

Në mungesë dhe me ordhër
Sekretar Përgjithshëm
Mustafa CARCIU

